



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	02.06/23	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë Komuna e Kaçanikut		
01	104/02 -	13186 Opština Kaçanik Municipal Kaçanik		

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 maj 2023. mori këtë:

V E N D I M

PËR ORGANIZIMIN E NJË PUNËTORIE DYDITORE ME ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK PËR PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL

1. Me këtë Vendim, Lejohet organizimi i një punëtorie dyditore brenda territorit të Kosovës, me anëtarët e Kuvendit të Komunës Kaçanik, për çështjen e Planit Zhvillimor Komunal.
2. Në punëtorinë që do të organizohet, përpos anëtarëve të KK, do të marrin pjesë edhe anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës, Grupi punues i formuar për hartimin e PZHK si dhe ekspertë nga DUKMM.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do kujdeset: Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.
4. Shpenzimet e nevojshme për realizimin e punëtorisë, do t'i bartë buxheti i komunës, ndërkaq do të kujdeset t'i zbatoj Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.
5. Ky Vendim hynë në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit;
3. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave;
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli